



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2018:025699

Datë: 18.07.2019

Numri i dokumentit: 00491223

P.nr.890/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Mentor Bajraktari, me procesmbajtësen Nushe Kadrija, sekretare juridike pranë kësaj gjykate, në lëndën penale kundër të akuzuarit B.T. nga Prizreni, për shkak të veprës penale të mashtrimit nga neni 335 par.1 të KPRK-së, i akuzuar nga ana Prokurorisë Themelore në Gjakovë-Departamenti përgjithshëm, sipas aktakuzës me numër PP.nr.1752/17, të datës 13.12.2017, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar, publik, **me datën 18.07.2019**, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Bajram Kryeziu, të dëmtuarit Gj.Q., të akuzuarit si dhe mbrojtësit të tij av.A.R. nga Prizreni, në të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 08.08.2019 e përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

B.T., nga i ati Q., e ëma S., e gjinisë B., data e lindjes..., në Prizren, ku edhe tani banon, i martuar-baba i dy fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar - shtetas i Republikës së Kosovës, numër personal....

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse me datë 12.12.2016, në fshatin D., Komuna e Gjakovës, afër tyrbes, me qëllim për t'i sjellë vetes dobi pasurore të kundërligjshme e takon të dëmtuarin Gj.Q., ashtu që fillimisht i prezantohet rrejshëm kinse është shok i djalit të tij, duke i kërkuar 130 Euro, para urgjente, me arsyetimin se kinse ka për të paguar veturën e aksidentuar, me premtimin se nesër do të ia kthejë të njëjtat, ashtu që pasi që shkon në shtëpi i dëmtuari Gj.Q. kupton se ishte mashtruar, meqenëse djali i tij nuk e kishte pasur shok.

Me këto veprime ka kryer veprën penale të mashtrimit nga neni 335 par.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në kuptim të neneve 4, 7, 17 par.1, 41, 42, 43, 45, 46, 47, 73, 74 dhe nenit 335 par.1 të KPRK-së, të akuzuarin e:

G J Y K O N

I. ME DËNIM ME GJOBË në shumë prej 200 (dyqind) Euro, të cilin dënim i akuzuari duhet ta paguajë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi dhe

II. ME DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve,

Me me kërkesën dhe pëlqimin e të akuzuarit B.T., konform nenit 47 të KPRK-së, dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, i ZËVENDËSOHET ME DËNIM ME GJOBË në shumën prej 1200 (njëmijëedyqind) Euro, të cilin dënim është i obliguar që ta paguajë në afat prej 2 (dy) muajve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë, gjykata do ta zëvendësojë dënimin me gjobë në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) ditëve, duke ia llogaritur për çdo ditë të kaluar në burg nga 20 (njëzet) Euro.

Ndërsa nëse i akuzuari B.T. nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj dënimin e zëvendësuar me gjobë, atëherë do të ekzekutohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Detyrohet i akuzuari B.T. nga Prizreni, që të dëmtuarit Gj.Q., Komuna e Gjakovës, t'ia kompensojë në emër të dëmit të shkaktuar kërkesën pasurore-juridike në shumën prej 130 (njëqindetridhjetë) Euro, në afat prej 1 (një) muaji nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcenim të përmbarimit.

Detyrohet i akuzuari që t'i paguajë shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumën prej 30 Euro, si dhe për programin për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 30 (tridhjetë) Euro, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

A r s y e t i m

1. Ecuria e procedurës

Prokuroria Themelore në Gjakovë-Departamenti përgjithshëm, pranë kësaj gjykate ka ngritur aktakuzën me numër PP.nr.1752/2017, të datës 13.12.2017, kundër të akuzuarit B.T. nga Prizreni, për shkak të veprës penale të mashtrimit nga neni 335 par.1 të KPRK-së. Prokurori i shtetit Bajram Kryeziu, gjatë shqyrtimit fillestar ka qëndruar në tërësi pranë aktakuzës kundër të akuzuarit B.T., dhe ka propozuar që i njëjti të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

I akuzuari B.T., gjatë seancës së shqyrtimit fillestar pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij av.A.R., ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet duke theksuar se çdo gjë që është shënuar në aktakuzë është e vërtetë, më vije keq për rastin që ka ndodhë, jam penduar për këtë veprim dhe jam i gatshëm që të dëmtuarit të ia kompensojë dëmin që ia kam shkaktuar, duke i kërkuar falje publikisht palës së dëmtuar dhe i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprime të këtilla.

Prokurori i shtetit Bajram Kryeziu, duke dhënë mendim rreth pranimin të fajësisë nga ana e të akuzuarit ka deklaruar se: nuk e kundërshtoj pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, pasi që i njëjti pranimin e fajësisë e bën me vetëdije dhe vullnet të plotë pa presion, i njëjti e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, po ashtu pranimi i fajësisë mbështetet edhe në provat dhe faktet që i janë bashkangjitur aktakuzës.

I dëmtuari Gj.Q., duke dhënë mendim rreth pranimin të fajësisë nga ana e të akuzuarit, ka deklaruar se: nuk e kundërshtoj pranimin e fajësisë nga i akuzuari dhe si i dëmtuar deklaroi se duke parë gjendjen e tij ekonomike dhe nga të dhënat që na dha vetë ai, nuk kam dëshirë që të dënohet, por parashtroi kërkesë pasurore juridike dhe kërkoj që të më kthehet shuma e parave në vlerë prej 130 Euro, pa kurrfarë kompensimi tjetër, por ka shtuar se për këtë person nuk kisha pas dëshirë që të takohem në të ardhmen 300 metra nga se nga këta persona gjithçka pritet.

Mbrojtësi i të akuzuarit B.T., av. A.R., duke dhënë mendim rreth pranimin të fajësisë nga ana e të akuzuarit ka deklaruar se: pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, të pranohet nga ana e gjyqtarit pasi që i njëjti ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimi i fajësisë mbështetet në provat dhe faktet dhe se pranimi i fajësisë bëhet vullnetarisht nga ana e të akuzuarit, i ka propozuar gjykatës që me rastin e marrjes së vendimit të peshojë rrethanat lehtësuese si pranimi i fajësisë, kërkim faljen ndaj të dëmtuarit, i dëmtuari është tërhequr nga ndjekja penale dhe si rrethanë posaçërisht lehtësuese të mirret fakti se i akuzuari është i gjendjes së dobët ekonomike, bashkëshorten e ka të papunë, i ka dy fëmijë në vijim të shkollimit, si dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra pasi që i njëjti edhe e ka kuptuar këtë pasojë pasi që gjendet edhe në vuajtje të dënimit dhe ky dënim ka arritur në risocializimin dhe edukimin e tij për pasojat e kryerjes së veprës penale të ngjashme.

2. Vlerësimi i pranimin të fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të palëve ka marr aktvendim me të cilin ka pranuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit ngase ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së. Gjatë pranimin të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij av.A.R., pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 253 paragrafët 1 dhe 2 të KPP-së, për pushimin e procedurës penale përkatësisht hedhjen e aktakuzës.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Andaj, duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, gjyqtari i vetëm gjykues e ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

- se i akuzuari B.T., me dashje ka kryer veprën penale të mashtrimit nga neni 335 par.1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

4. Elementet e veprës penale

Në nenin 335 paragrafi 1 të KPRK-së, është parashikuar se formën themelore të veprës penale të mashtrimit e kryen: *“Kushdo që me anë të paraqitjes së rreme të fakteve apo duke fshehur faktet dhe me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për veten apo personin tjetër, ose për t'i shkaktuar dëm material personit tjetër, e mashtron apo vazhdon lajthimin e personit tjetër dhe me këtë e nxit një person që të kryejë apo të mos kryejë një veprim në dëm të pasurisë së tij apo të pasurisë së personit tjetër, dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet .”*

5. Vendimet e gjyqtarit të vetëm gjykues

Andaj, duke u bazuar edhe në gjendjen faktike të vërtetuar, gjyqtari i vetëm gjykues duke u bazuar në dispozitat ligjore të lartpërmendura, të akuzuarin B.T. nga Prizreni, e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale të mashtrimit nga neni 335 par.1 të KPRK-së, ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 dhe 74 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit: se është i papunë, i gjendjes së dobët ekonomike, është baba i dy fëmijëve, në gjykim ka pas qëndrim tejet korrekt. Si rrethanë posaçërisht lehtësuese gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë në shqyrtimin fillestar për veprën penale për të cilën ngarkohet, pendimin e tij dhe gatishmërinë për të ia kompensuar dëmin palës së dëmtuar, si dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra penale. Ndërsa si rrethana rënduese gjykata ka gjetur se i akuzuari ka qenë i dënuar më parë me dënim me burgim për vepra penale të ngjashme me aktgjykime e plotfuqishme me të cilin edhe tani është në vuajtje të dënimit me burgim. Kështu që duke mos gjetur rrethana tjera rënduese për të akuzuarin, gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimet e shqiptuara si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 41 dhe 50 i KPRK-së dhe këto dënime si të tilla të shqiptuara sipas bindjes së gjykatës janë në proporcion me veprat penale të kryera dhe me rrethanat personale të cilat i posedojnë të akuzuarit dhe se dënimet e shqiptuar do të ndikojnë në parandalimin e të akuzuarve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjnë rehabilitimin e tyre, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shprehin gjykimin shoqëror për veprat penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

7. Zëvendësimi i dënimit me burgim në dënim me gjobë

Gjyqtari i vetëm gjykues, duke u bazuar në nenin 47 të KPRK-së, me kërkesën dhe pëlqimin e të akuzuarit B.T., dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, e ka zëvendësuar me dënim me gjobë në shumë prej 1200 (njëmijedyqind) Euro, duke i marr për bazë rrethanat e lartcekura.

8. Vendimi lidhur me kërkesën pasurore-juridike

Në bazë të nenit 463 par. 2 lidhur me par. 1 të KPP-së, gjykata ka vendosur që i akuzuari B.T. nga Prizreni, t'ia kompensoi të dëmtuarit Gj.Q., Komuna e Gjakovës, në emër të dëmit të shkaktuar-kërkesën pasurore-juridike në shumë prej 130 €uro, në afat prej 1 (një) muaji nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcenim të përmbartimit.

9. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe shpenzimet e paushallit gjyqësor është marrë konform nenit 450 par.1 dhe 2 lidhur me nenin 453 par.1 të KPP-së, ndërsa për programin për kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform nenit 39 par.3 nënpar.3.1 të Ligjit Nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, komfor nenit 365 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
- Departamenti përgjithshëm -
P.nr.890/17, më datë 18.07.2019

Procesmbajtësja,
Nushe Kadrija

Gjyqtari i vetëm gjykses,
Mentor Bajraktari

UDHËZIME JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.